

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Nebojsa Boriqiq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve: O.,E. dhe F. K., nga Komuna e Malishevës, të cilët i përfaqëson av. D. K., nga Malisheva, kundër të paditurve Agjencioni Pyjor i Kosovës, në Prizren, të cilën e ka përfaqësuar me autorizim N. H., dhe Komuna e Malishevës, të cilën e ka përfaqësuar asistenti i Avokatit Publik M. S., në praninë e të autorizuarës nga Ministria e Drejtësisë N. A., për shkak të vërtetimit të pronësisë, duke vendosur sipas Propozimit të paditësve për përsëritjen e procedurës kontestimore, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.14/2017 datë 8.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 28.09. 2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

I.LEJOHET përsëritja e procedurës dhe priset aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.14/2017 dt.8.03.2017.

II.REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i paditësve O.,E. dhe F. K., të gjithë nga Komuna e Malishevës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3642/2013 datë 31.10.2016.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3642/2013 të dt. 31.10.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësve dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë C.nr.63/2008 dt.12.07.2013, me të cilin është refuzuar si e pabazuar

kërkesëpadia e paditësve me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se janë pronarë në ngastrat kadastrale nr...,në vendin e quajtur "...",sipas fletës poseduese nr...,në sipërfaqe të përgjithshme 4.50.00 ha, ZK Drenoc.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar sipas revizionit të paditësve, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3642/2013 dt.31.10.2016, me aktvendimin Rev.nr.14/2017 dt.8.03.2017 e ka hedhur si të palejuar revizionin e paditësve, për shkak të vlerës së vogël të objektit të kontestit që në padi ishte cekur vlera prej 100€ dhe se për të qenë i lejuar revizioni si në rastin konkret, me dispozitën e nenit 211.3 të LPK-së, kërkohet që vlera e kontestit të jetë mbi 3.000€.

I autorizuari i paditësve me dt.15.05.2017 ka paraqitur propozim për përsëritjen e procedurës së përfunduar me aktvendimin e sipër-cekur të kësaj gjykate.

E paditura e parë ka paraqitur përgjigje në propozimin për përsëritjen e procedurës, me propozim që propozimi i paditësve të refuzohet si i pabazuar.

Duke pasur parasysh se shkak për përsëritjen e procedurës në këtë rast ka të bëjë ekskluzivisht me procedurën në Gjykatën Supreme të Kosovës, me rastin e vendosjes sipas revizionit të paditësve kundër aktgjykimit të goditur, pas shqyrtimit të propozimit për përsëritjen e procedurës ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Kjo për faktin sepse paditësit nëpërmjet parashtresës me shkrim C.nr.63/2008 dt.24.01.2012 kanë provuar se, që atëherë, kishin bërë precizimin e vlerës së objektit të kontestit në padi, në shumë prej 4.900€,e cila parashtresë gjendet në shkresat e lëndës dhe i është bashkangjitur propozimit për përsëritje të procedurës. Prandaj, nga këtu, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se në kuptim të dispozitave të nenit 232 dhe nenit 240 të LPK-së, duhet lejuar përsëritjen e procedurës sipas propozimit të autorizuarit të paditësve.

Gjykata Supreme e Kosovës, tani në procedurën e përsëritur, përkitazi me revizionin e paraqitur të paditësve kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë Ac.nr.3642/2013 dt.31.10.2016, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i paditësve është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësit pretendojnë se janë pronarë të paluajtshmërisë së përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e cila tani është e shënuar në fletposedimin nr..., ZK-L., në emër të së paditurës së parë, Agjencioni Pyjor i Kosovës. Me aktvendimin e Komisionit për shqyrtimin e uzurpimeve arbitrare të paluajtshmërisë në pronësi shoqërore me nr..., dt.20.03.1963, paraardhësit të paditësve J. (F) K., nuk i është pranuar e drejta në pronësi në paluajtshmërinë shoqërore, në pjesën e ngastrës kadastrale nr..., në vendin e quajtur "...” Zk-Drenoc dhe është regjistruar në emër të Pylltarisë sipas fletës poseduese nr. ..., e po ashtu edhe ngastra kadastrale me sipërfaqe prej 1.00.00 ha. Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka pasur të drejtën e ankesës në procedurën administrative, mirëpo, nga shkresat e lëndës nuk është vërtetuar se ishte ushtruar ankesë. Me datën 23.02.2012 Gjykata e shkallës së parë, së bashku me ekspertin e gjeodezisë ka dalë në vendin e ngjarjes dhe pas identifikimit të pronës, gjeometri ka hartuar ekspertizën, sipas së cilës ngastrat ..., 3359m dhe ..., të evidentuara në fletën poseduese nr..., janë në emër të Ekonomisë së Pyjeve në Malishevë dhe se nuk ka të dhëna se ndonjëherë paditësit apo paraardhësi i tyre kanë qenë pronarë të paluajtshmërisë kontestuese. Ndërkohë që, paditësit pretendojnë se paluajtshmërinë kontestuese e kanë trashëguar nga babai i tyre, të cilën ai e ka poseduar që nga koha e Turqisë, deri në v.1936, se më pastaj ai dhe paditësit më vonë, kanë qenë në shfrytëzim, përkatësisht në posedim të kësaj paluajtshmërie.

Gjykata e shkallës së parë, në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, ka gjetur se është e pabazuar kërkesëpadia e paditësve, ndaj, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo gjykatë kujdeset, sipas detyrës zyrtare e as me shkelje të

tjera të LPK-së, të pretenduara nga revizioni. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale dhe të drejtës materiale nuk mund t'i vejnë në pyetje aktgjykimet e instancave më të ulëta.

Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët përkitazi me refuzimin e kërkesës së paditësit, pasi që janë dhënë arsye bindëse dhe të pranueshme edhe nga kjo Gjykatë. Kështu me nenin 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, parashihet se e drejta e pronësisë fitohet sipas ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi apo me vendim të organit shtetëror në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me ligj. Në rastin konkret juridiko-civil, paditësit nuk e kanë provuar as bazën juridike e as mënyrën e fitimit (iustus titullus-modus acquirendi) të paluajtshmerisë kontestuese. Në kontekstin e mësipërm duhet theksuar faktin se edhe me aktvendimin e Komisionit për shqyrtimin e marrëdhënieve juridiko pasurore të krijuara me uzurpim arbitrarë të tokave në pronësi shoqërore të dt.20.03.1963,paraardhësit të paditësve nuk i është pranuar pronësia në paluajtshmerinë kontestuese dhe nga atëherë ajo evidentohet si pronësi shoqërore e evidentuar në emër të së paditurës së parë.

Po ashtu, edhe thëniet e revizionit, përkatësisht të paditësve se ata e kanë qenë edhe në posedim të paluajtshmerisë kontestuese, në kontekst të fitimit të pronësisë, nuk qëndrojnë, për faktin sepse për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues (usucapio) përveç posedimit të sendit dhe kohëzgjatjes së posedimit prej 20 viteve, sipas dispozitës së nenit 28.4 dhe 5 të LMMTHPJ-së, kërkohet që poseduesi të jetë i ndërgjegjshëm respektivisht me mirëbesim, ndërsa, në rastin konkret, paditësit e kanë ditur se paluajtshmeria kontestuese është pronësi shoqërore dhe kanë ditur për aktvendimin e sipërpërmendur të Komisionit për shqyrtimin e uzurpimeve arbitrare të tokave në pronësi shoqërore. Ndërkohë që, po ashtu, sipas nenit 29 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike (në fuqi atëherë dhe i zbatueshëm për këtë rast), parashihej se “Në sendet në pronësi shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me mbajtje”(parashkrim fitues).

Për arsyet e sipërpërmendura revizioni i paditësve u refuzua si i pa themeltë, andaj, sipas dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

CPP.nr.3/2017 datë 28.09. 2017

Kryetar i kolegjit,  
Mr.sc. Muhamet Rexha

